



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:237101
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05541435

C.nr. 590/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.A nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, të cilin me e përfaqëson N.A nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurit B.B nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Vërtetim i pronësisë, jashtë seance me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr. 590/18 e datës 31.12.2018, e paditësit G.A nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurit B.B nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, lidhur me çështjen kontestimore-Vërtetim i pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësi G.A nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, përmes të autorizuarit të tij me datë 31.12.2018, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për vërtetimin e pronësisë, kundër të paditurit B.B nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 02.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se paditësi me të paditurin e kanë rregulluar çështjen e vërtetimit të pronësisë dhe se nuk ka interes juridik për vazhdimin e procedurës, andaj edhe e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:237101
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05541435

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr. 590/18, me datë 03.04.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.